

VENDIM
Nr. 637, datë 5.10.2022

**PËR DISA NDRYSHIME DHE SHTESA NË VENDIMIN NR. 867, DATË 12.12.2007,
TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, “PËR SHPRONËSIMIN, PËR INTERES PUBLIK,
TË PRONARËVE TË PASURIVE TË PALUAJTSHME, PRONË PRIVATE, QË
PREKEN NGA REALIZIMI I PROJEKTIT “NDËRTIMI I RRUGËS PARALELE,
“TIRANË-VORË”, (KRAHU I MAJTË)”**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 5, 20 e 21, të ligjit nr. 8561, datë 22.12.1999, “Për shpronësimet dhe marrjen në përdorim të përkohshëm të pasurisë, pronë private, për interes publik”, të ndryshuar, me propozimin e zëvendëskryeministrit dhe ministër i Infrastrukturës dhe Energjisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Në vendimin nr. 867, datë 12.12.2007, të Këshillit të Ministrave, bëhen këto ndryshime dhe shtesa:

a) Kudo në vendim, emërtimi “Drejtoria e Përgjithshme e Rrugëve” zëvendësohet me “Autoriteti Rrugor Shqiptar”.

b) Pika 3 ndryshohet, si më poshtë vijon:

“3. Pronarët e pasurive të paluajtshme, që shpronësohen, të kompensohen në vlerë të plotë, sipas masës përkatëse që paraqitet në tabelën, që i bashkëlidhet këtij vendimi, për sipërfaqen 63 946 (gjashtëdhjetë e tre mijë e nëntëqind e dyzet e gjashtë) m², tokë arë, të vlerësuar me çmimet 4 281 lekë/m², 3 000 lekë/m², 2 538 lekë/m², 448 lekë/m², me vlerë 230 900 730 (dyqind e tridhjetë milionë e nëntëqind mijë e shtatëqind e tridhjetë) lekësh, për sipërfaqen 8 142 (tetë mijë e njëqind e dyzet e dy) m², tokë truall, të vlerësuar me çmimet 14 602 lekë/m² dhe 3 116 lekë/m², me vlerë 74 071 112 (shtatëdhjetë e katër milionë e shtatëdhjetë e një mijë e njëqind e dymbëdhjetë) lekë, për objekte, me vlerë 19 704 189 (nëntëmbëdhjetë milionë e shtatëqind e katër mijë e njëqind e tetëdhjetë e nëntë) lekë, me një vlerë të përgjithshme shpronësimi 324 676 031 (treqind e njëzet e katër milionë e gjashtëqind e shtatëdhjetë e gjashtë mijë e tridhjetë e një) lekë.”.

c) Në pikën 4, vlera “... 445 000 (katërqind e dyzet e pesë mijë) lekë ...” zëvendësohet me “... 495 000 (katërqind e nëntëdhjetë e pesë mijë) lekë ...”.

ç) Pika 5 ndryshohet, si më poshtë vijon:

“5. Vlera e përgjithshme e shpronësimit, prej 324 676 031 (treqind e njëzet e katër milionë e gjashtëqind e shtatëdhjetë e gjashtë mijë e tridhjetë e një) lekësh, të përballohet në masën:

- 324 063 167 (treqind e njëzet e katër milionë e gjashtëdhjetë e tre mijë e njëqind e gjashtëdhjetë e shtatë) lekë nga llogaria e veçantë e Ministrisë së Financave në “Bankën e Shqipërisë;

- 612 864 (gjashtëqind e dymbëdhjetë mijë e tetëqind e gjashtëdhjetë e katër) lekë, nga buxheti i Autoritetit Rrugor Shqiptar.”.

d) Pas tabelës bashkëlidhur vendimit shtohet tabela, që i bashkëlidhet këtij vendimi.

2. Agjencia Shtetërore e Kadastrës, Drejtoria Vendore Kamzë-Vorë, të pasqyrojë në kartelat e pasurive të paluajtshme, në hartat treguese sipas sistemit të regjistrimit, pasuritë e shpronësuara në emër të ARRSH-së pas miratimit të shpronësimit për interes publik të pasurive, pronë private, si dhe pasuritë e llojit “arë” që u mbeten subjekteve pas shpronësimit.

3. Ngarkohen Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë, Autoriteti Rrugor Shqiptar, Agjencia Shtetërore për Shpronësimin, Agjencia Shtetërore e Kadastrës dhe Drejtoria e Administrimit dhe Mbrojtjes së Tokës pranë Këshillit të Qarkut Tiranë për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTËR
Belinda Balluku

LISTA EMËRORE SHITESË E PRONARËVE QË SHPRONËSOHEN, PËR PRONAT TË CILAT
PREKEN NGA REALIZIMI I PROJEKTTIT “NDËRTIMI I RRUGËS PARALELE, “TIRANË–VORË”,
(KRAHU I MAJTË)”

Nr .	PRONARI			Zona kad.	Numri i pasurisë	Sip. totale	Lloji i pas.	Sipërfaqe shpronësimi	Çmimi lek/(m ²)	Vlera (lek)	Shënime	Adresa
	Emri	Atësi a	Mbiemri									
1	Eugen	Ali	Elezaj	3974	243/29	5000	arë	1021	448	457,408	Konfirmuar nga ASHK-ja	Tiranë
2	Eugen	Ali	Elezaj	3974	247/80	1254	arë	347	448	155,456	Konfirmuar nga ASHK-ja	Rruga e Kavajës, lagjja 1, godina, hyrja, apartamenti
Vlera totale paraprake										612,864		